



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
S-035
Prishtinë, më 9 dhe 10 korrik 2015

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 9 DHE 10 KORRIK 2015**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi, Xhavit HALITI nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në fillim të seancës, kryetari Kadri Veseli e mbajti një fjalë rasti në lidhje me 20-vjetorin e Masakrës së Srebrenicës, të shkaktuar nga forcat ushtarake serbe, duke e vlerësuar si masakrën më të madhe në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Ai theksoi se fjalët gjenocid dhe spastrim etnik sërish u ngjallën në zemër të Evropës dhe atë në fund të shekullit XX. Drejtësia nuk ka ardhur akoma në vendin e vet, ngase ish-regjimi serb edhe pas vitit 1995 vazhdoi të shkaktojë masakra të reja, siç është rasti me shumë të tilla në Kosovë.

Kuvendi e mbajti një minutë heshtje në shenjë nderimi të viktimave të Masakrës së Srebrenicës.

* * *

Pastaj, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Qerim Bajrami, Emilija Rexhepi, Faton Topalli, Time Kadrijaj, Zafir Berisha, Nait Hasani, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Teuta

Haxhiu, Mexhide Mjaku-Topalli, Salih Salihu, Xhavit Haliti, Enver Hoti, Besa Baftija, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri dhe ministri Imet Rrahmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Nezir Çoçaj parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me atë se sa është buxheti i ndarë për hulumtime dhe kërkime shkencore në institutet e pavarura publike, universitetet publike, bartësit privatë të arsimit të lartë dhe Akademinë e Shkencave dhe Arteve.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Nezir Çoçaj.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me punën e Komisionit të formuar për funksionalizimin e Kardiokirurgjisë.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Besa Baftija parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me çështjen e mos pagesave të specializantëve të cilët e mbajnë orarin e rregullt nëpër ambulanca të mjekësisë primare, e po ashtu gjenden edhe në specializim.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Besa Baftija.

Deputetja Besa Gaxherri parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria që ai drejton lidhur me çështjen e degradimit të lumenjve në nivel vendi, me theks të veçantë rreth ankesës së komunitetit të fshatit Gllaviqicë dhe banorëve të Komunës së Pejës për shkatërrimin e lumit Lumbardh (Bistricë).

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Besa Gaxherri.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me informatën dhe ndërhyrjen për ta penguar shitjen e çerdhes së fëmijëve “Integj”, e ndërtuar me kontributin e qytetarëve të Gjilanit, si dhe për të gjitha hapësirat tjera që i shërbejnë arsimit.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputeti Faton Topalli parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me opsionin e qeverisë për Gjykatën Speciale pas refuzimit të Kuvendit që ta formojë në formën e propozuar nga Qeveria.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtroi pyetje për ministren Hykmete Bajrami në lidhje me evazionin fiskal, që paraqet një abuzim të rëndë, ndaj shkelësve të cilët importojnë naftë jocilësore e cila sipas ekspertëve të pulmologjisë është shkaktare e sëmundjeve të rënda, duke rrezikuar seriozisht shëndetin publik, e që përbën po ashtu një vepër të rëndë penale, a është proceduar në organet e Prokurorisë ndonjë rast i tillë?

Ministrja Hykmete Bajrami nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Faton Topalli parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me përgatitjet e ministrisë që ai drejton lidhur me zbatimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore dhe kur do të fillojë zbatimi i tij?

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetit Faton Topalli.

Deputetja Shqipe Pantina parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me pozitat e identifikuara si deficitare në fondin për kuadro për të cilat bartësit e këtyre pozitave janë

paguar me pagë shtesë dhe çfarë kualifikimesh profesionale kanë pasur bartësit e këtyre pozitave?

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Lahi Brahimaj parashtroi pyetje për ministrin Lutfi Zharku në lidhje me masat e ndërmarra për mirëmbajtjen e rrugës Bec-Jabllanicë të Komunës së Gjakovës, dhe a do të jetë kjo rrugë nën përkujdesjen e Ministrisë, apo në atë të Komunës së Gjakovës?

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Lahi Brahimaj.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me zbatimin e Ligjit për kontrollin e duhanit.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

* * *

Në vazhdim, deputeti Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, propozoi që shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Për propozimin e deputetit Naser Osmani u deklaruan deputetët: Labinotë Demi-Murtezi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryesuesi Xhavit Haliti e hodhi në votim miratimin e propozimit të deputetit Naser Osmani për shmangie nga Rregullorja lidhur me shqyrtimin e projektligjit të lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,

Kundër----- 19,

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 të bëhet në seancën plenare më 9 korrik 2015.
2. Amendamentet eventuale për rishikimin e buxhetit mund t'i adresohen Komisionit për Buxhet dhe Financa deri më 13 korrik 2015.
3. Komisionet e përhershme deri më 14 korrik 2015 duhet ta shqyrtojnë projektligjin dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit për Buxhet dhe Financa.
4. Komisioni për Buxhet dhe Financa deri më 15 korrik 2015 duhet ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare.
5. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 të bëhet në seancën plenare më 16 korrik 2015.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, propozoi që për rendin e ditës së punimeve të seancës së sotme të hiqet pika e 8-të e rendi i ditës - Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Për propozimet e deputetit Adem Grabovci u deklaruan deputetët: Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Adem Grabovci.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----52,

Kundër ----- 19

Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e shtyu për një seancë tjetër të radhës pikën e 8-të të rendit të ditës - Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. *Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për faljen e borxheve publike,*
6. *Shqyrtimi i raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014,*
7. *Shqyrtimi i raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014,*
8. *Votimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit,*
9. *Votimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike,*
10. *Votimi për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,*
11. *Votimi i Raportit vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2014.*

* * *

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më: 18 e 25 qershor, më 18 qershor - seancë e jashtëzakonshme, 25 qershor e 2 korrik dhe më 26 qershor 2015.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Ministri Avdullah Hoti tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Dispozitat e këtij e Projektligji janë të obligueshme për të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës të cilat trajtohen në kuadër të këtij ligji.

Më pas ministri theksoi se Fondet e ndara për Kontigjencë dhe Paga për pagesën e përvojës së punës në kategorinë ekonomike “Paga dhe Mëditje” në Ministrinë e Financave, do të transferohen tek organizatat buxhetore në të njëjtën kategori nga Ministria, në përputhje me Vendimin e aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Ministria e Financave do të përgatit specifikimin e ndarjeve sipas nënprogrameve të organizatave buxhetore në kategorinë ekonomike “Paga dhe Mëditje”.

Transferet e tilla nuk janë subjekt i limitimeve të transfereve të përcaktuara në nenin 30 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Financave dhe Përgjegjësitë dhe të nenit 13 të këtij ligji.

Në vazhdim ai tha se ndryshimet dhe plotësimet e parapara në këtë Projektligj janë të harmonizuara edhe me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Në pas, ministri u fokusua në sqarimin e parametrave tjerë të organizatave buxhetore, të paraparë në Projektligj.

Në fund, ministri Avdullah Hoti i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Fjala e ministrit Avdullah Hoti është i dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi më pas hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Labinotë Demi-Murtezi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jelena Bontiq, në emër të Grupit Parlamentar LS; Enver Hoti, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”; Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Albin Kurti, ministri Avdullah Hoti, kryeministri Isa Mustafa, Bali Muharremaj, Shpejtim Bulliqi, Faton Topalli, Zafir Berisha, Shaip Muja, Muhamet Mustafa, Raif Qela, Salih Salihu, Pal Lekaj, Blerta Deliu-Kodra, Murat Hoxha, Rexhep Selimi, Teuta Haxhiu, Gëzim Kelmendi, Bekim Haxhiu, Hajdar Beqa dhe Ismajl Kurteshi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Meqë nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për të proceduar me votimin e Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, kryesuesi i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:30 minuta për të vazhduar nesër, në orën 10:00.

* * *

E premte, 10 korrik

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 9 korrik

Seancën e drejtoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

4. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e djeshme. Por, në seancën e djeshme nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për votimin e këtij projektligji.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61 ,
Kundër ----- 17,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i paraqesin raportet me rekomandime, për seancën plenare, më 16 korrik 2015.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për faljen e borxheve publike

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për faljen e borxheve publike.

Ministri Avdullah Hoti tha se qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për faljen e borxheve publike, që personat fizik dhe juridik kanë ndaj Institucioneve të Administratës Shtetërore, Komunave dhe ndërmarrjeve publike në Republikën e Kosovës, deri më 31 dhjetor 2008.

Ai në vazhdim theksoi se ky projektligj do të shërbej për ngritjen e disiplinës së përgjithshme të personave fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës përballë obligimeve të tyre publike. Kjo do të ndikojë pozitivisht në të hyrat e Qeverisë së Kosovës. Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji. Fjala e z. Avdullah Hoti, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa Labinothë Demi-Murtezi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Glauk Konjufca - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar “6+” si dhe Xhavit Haliti, Naim, Naim Fetahu dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Projektligjit për faljen e borxheve publike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin Nr. 05/L-43 për faljen e borxheve publike.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision FunkSIONAL dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014

Kryesuesi i njoftoi deputetët se raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014, e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Naser Osmani, paraqiti dhe arsyetoi raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Labinothë Demi-Murtezi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si dhe Muhamet Mustafa, Faton Topalli, Naim Fetahu dhe Shqipe Pantina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014

7. Shqyrtimi i raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014

Kryesuesi i njoftoi deputetët se raportin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014, e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Naser Osmani e paraqiti dhe arsyetoi raportin me rekomandime në emër të Komisioni Funkcional.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Labinotë Demi-Murtezi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si dhe Besim Beqaj, Fatmir Rexhepi, Ismajl Kurteshi, Besa Baftiu dhe Faton Topalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 56,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014

8. Votimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 7 maj 2015, ndërsa në seancën plenare të mbajtur me datë 14 maj 2015, Kuvendi në mungesë të kuorumit nuk ka mundur të procedojë me votim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me Peticionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nxori këto:

REKOMANDIME

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bisedimet Kosovë-Serbi, të kërkojë që brenda gjashtë muajve të përfshihet në agjendën e bisedimeve zbardhja e fatit të personave të pagjetur dhe me Raportin për rezultatet dhe sfidat në këtë proces, të njoftohet Kuvendi i Republikës së Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të sigurojë fonde për funksionalizimin e mekanizmave përkatës profesional-teknik për punë më efektive për identifikimin e mbetjeve mortore dhe për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.
3. Subjektet bartëse të politikës ndër parlamentare dhe të politikës së jashtme të Kosovës në agjendat e takimeve me përfaqësuesit e OKB-së, BE-së dhe të shteteve me ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare ta fokusojnë në mënyrë të veçantë dhe me prioritet zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, në dritën e zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe për këtë ta njoftojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës, në baza gjashtëmujore.
4. Të gjithë bartësit e detyrave sipas këtyre rekomandimeve t'i qasen në mënyrë të veçantë zbardhjes së fatit të mr. Ukshin Hoti, për shkak të rrethanave të zhdukjes së tij, të planifikuar nga strukturat komanduese ushtarake-policore të shtetit serb dhe nga Drejtoria e Burgut të Dubravës në Istog.

9. Votimi i Rekomandimeve të Komisionit për të Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 8 maj 2015, mirëpo, për shkak të mospjesëmarrjes së deputetëve në procedurën e votimit, kjo pikë është proceduar në seancën plenare të datës 14 maj 2015.

Në seancën plenare të mbajtur me 14 maj 2015, Kuvendi në mungesë të kuorumit nuk ka mundur të procedojë me votim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i hodhi në votim rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nxori këto:

REKOMANDIME

1. Zyra e Rregullatorit për Energji, në afat prej një muaji nga dita e miratimit të këtij rekomandimi t'ia paraqesë për njoftim Kuvendit të Republikës së Kosovës një raport të veçantë për të gjitha çështjet e ngritura me peticion lidhur me dy rritjet e fundit të çmimit të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe analizën e detajuar të çmimeve.

2. Qeveria ta procedojë në Kuvend në afatin sa më të shpejtë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin në Vlerën e Shtuar dhe të propozohet zbritja e TVSH-së në konsumin e energjisë elektrike nga 16% në 8%.

3. Qeveria ta rishikojë listën e përfituesve të kategorive sociale dhe të identifikohen përfituesit që kanë ndryshuar statusin financiar, në mënyrë që të bëhet rishpërndarja e mjeteve buxhetore, në emër të pagesës së energjisë elektrike për familjet që ende kanë nevojë.

4. Të mos bëhet asnjë rritje e re e çmimit të energjisë elektrike deri në rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

10. Votimi për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 2 korrik 2015, mirëpo në mungesë të pjesëmarrjes së deputetëve në procedurën e votimit, kjo pikë është radhitur për votim në seancën e sotme.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin për emërimin e z. Elvedin Durguti - anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 19,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

1. Z. Elvedin Durguti emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.

2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat dy (2) vjet.

11. Votimi i raportit vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2014

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 25 qershor dhe 2 korrik 2015.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e raportit vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2014

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 54,
Kundër ----- 19,
Abstenime ----- 8

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Kryesuesi mbylli punimet e seancës së sotme, në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

E përgatiti:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale